



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:108778
Datë: 16.11.2021
Numri i dokumentit: 02404076

C.nr.714/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Afijete Sada – Glllogjani, me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. G. nga Gjakova, përfaqësuar nga Fadil Sinanaj avokat në Gjilan, rruga “Bulevardi i Pavarësisë” H-35, k-2, nr. 4, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përfaqësuar nga i autorizuari M. Gj., kontest punepagesë e shpërblimeve jubilarë, vlera e kontestit 2,039.73 euro, pas përfundimit të shqyrtimit përgatitor – publik, të mbajtur me 10 nëntor 2021, në të cilin morën pjesë të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me 16 nëntor 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit A. G. nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,039.73 euro (dymijë e tridhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e tre cent) në emër të shpërblimit jubilar, për 30 vite përvojë pune në vlerë të tri pagave mujore nga 679.91 euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 10 nëntor 2021, e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269.00 euro (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi nëpër përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi kundër të paditurës për kompensim të shpërblimit jubilar. Paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në punët dhe detyrat e punës: specialist Stomatolog në QKMF Gjakovë dhe ka 31 vjet përvojë pune tek e paditura. Paditësi disa herë me kërkesë verbale iu ka drejtuar të paditurës në raport me kompensimin e shpërblimit jubilar, por deri me tani e njëjta nuk i është përgjigjur. Kërkesa e paditësit është e parashtruar konform dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale në nenin 17 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të tre pagave mujore që i ka realizuar. Meqenëse e paditura nuk ka përmbushur obligimin e saj, paditësi i është drejtuar kësaj gjykate për të kërkuar realizimin e drejtës së tij, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit ka mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke i propozuar gjykatës që të bëjë administrimin e provave të paraqitura me padi. Pas administrimit provave gjykata në tërësi të e aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Sa i përket pretendimeve nga përgjigja në padi në raport me mungesën e legjitimiteti real pasiv të njëjtat i ka

kundërshtuar, pasi që siç dihet Kontrata Kolektive Sektoriale është e zbatueshme për tri nivele të sistemit shëndetësor, atë parësor që është nën menaxhimin e komunës, në këtë rast të paditurës, sistemin dytësor dhe tretësor. Meqë Republika e Kosovës është shtet i thjeshtë unitar atëherë raportet mes qeverisë dhe asociacionit të komunave apo komunave në veçanti janë në diskrecion të tyre që ti harmonizojnë qëndrimet e veta. Andaj, edhe pse komunat veç e veç nuk e kanë nënshkruar këtë Kontratë Kolektive kjo kontratë është nënshkruar në bazë të Ligjit të punës për sektorin e shëndetësisë në nivel të Republikës së Kosovës.

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se pas administrimit të provave është vërtetuar themelësia e kërkesëpadisë, ashtu që nga kontrata e punës është vërtetuar fakti se paditësi është i punësuar tek e paditura në kohë të pacaktuar, nga vërtitmi mbi përvojën e punës është vërtetuar se paditësi ka 31 vite të përvojës në punë dhe se nga lista e pagës e muajit prill 2021 është vërtetuar se i njëjti pagën mujore e ka realizuar në shumë prej 679.91 euro. Andaj, pas vlerësimit të këtyre provave kërkoj gjykata në tërësi të e aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar në legjislacionin në fuqi dhe të e detyrojë të paditurën që paditësi të ia paguajë shpërblimin jubilar në shumë prej 2,039.73€, në vlerë të tri pagave mujore për 30 vite të përvojës në punë, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë për taksë gjyqësore në shumë prej 30.00 euro, për përpilim të padisë në shumë prej 104.00 euro, si dhe për përfaqësim një seancë shumën prej 135.00 euro.

E paditura në përgjigje në padi ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për nga baza ligjore, sepse e njëjta është e pa bazuar dhe në kundërshtim të plotë me gjendjen faktike dhe juridike. Për të paditurën është e pakontestueshme, që paditësi është në marrëdhënie pune dhe vazhdon të punojë tek e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjakovë. Legjislacioni që e qeverisë marrëdhënien e punës së paditësit me të paditurën është Ligji i punës nr. 03/L-212, i cili rregullon çështjen e krijimit, kohën e ekzistimit dhe shkëputjes së marrëdhënies së punës. Duke pasur parasysh që si palë nënshkruese e Kontratës Kolektive Sektoriale është Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, atëherë nga kjo rezulton se këtu të paditurës QKMF i mungon legjitimiteti real pasiv dhe se e njëjta nuk mund të obligohet që të i kompensojë pagat jubilarë të paditësit. Me propozim për gjykatën që t'a refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë.

I autorizuari i të paditurës gjatë shqyrtimit ka kundërshtuar kërkesëpadinë. Duke u mbështetur në Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe Ligjin mbi shëndetësinë, organi i cili menaxhon dhe financon sistemin parësor shëndetësor pjesë e të cilit është dhe paditësi është komuna, në këtë rast Komuna e Gjakovës. Andaj, asnjë institucion tjetër nuk mund të obligojë pagesën e çfarëdo shpenzimi e cila paraprakisht nuk aprovet nga Komuna. Duke u mbështetur në të lartë cekurat dhe në provat të cilat ekzistojnë, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia të hedhet si e pathemeltë. Në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe pohimeve të lartcekura, duke kontestuar bazën ligjore të kërkesëpadisë.

Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjatë shqyrtimit Gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: Kontratën e punës nr. 404, datë 27 mars 2021, vërtetimin nr. 201/38 të datës 05 shkurt 2021, listën e pagave të muajit prill 2021 dhe patentë shoferin- nr. personal . . . , me ç'rast pas vlerësimit të secilës provë veç e veç

dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke, bazuar në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Në mes të palëve nuk është kontestuese lartësia e kërkesë padisë sa i përket pagave të kërkuara nga se në pagën neto 829.91 euro është hequr shtesa emergjente Covid 19 në shumë 150.00 euro.

Me Kontratën e punës nr. 404, datë 27 mars 2012, u vërtetua fakti se paditësi ka lidhur kontratë pune me të paditurën Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjakovë – Departamenti Oral (ku sipas nevojës mund të caktohet edhe në QMF tjera në kuadër të QKMF-së), duke filluar nga 01 prill 2012, vërtetimi me nr. 201/38 i datës 25 maj 2021, i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjakovë, provon rrethanën se paditësi është i punësuar tek e paditura në detyrat e punës: specialist Stomatolog në QKMF – stomatologji – me kontratë pune në kohë të pa caktuar dhe ka 31 vite përvojë pune. Duke u bazuar në listën e pagave (muajt prill 2021), i njëjti ka 31 vjet përvojë pune dhe realizon pagë mujore neto në vlerë prej 829.91 euro (-150 euro shtesat nga Covid 19 = 679.91 euro).

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe ka përvojë pune 31 vite, e që prej kohës kur i ka mbushur 31 vjet përvojë pune, të njëjtit nuk i është paguar pagesa për shpërblim jubilar në vlerë të tre pagave mujore, të parapara me nenin 17 paragrafi 3 pika 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS). Mos pagesën e këtyre pagave e ka pohuar edhe e paditura përmes përgjigjes në padi, duke pretenduar se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv dhe se e njëjta nuk mund të obligohet që të i kompensojë pagat jubilarë të paditësit.

Lidhur me bazën e kërkesëpadisë gjykata vendosi duke ju referuar Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të nënshkruar me datë 11 qershor 2018 nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 17 paragrafi 3 pika 3.3, parashihet se: “Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit në vlerë të tre pagave mujore të tij”. Gjukata vlerësoi se Kontrata Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS) është e aplikueshme në rastin konkret, e njëjta ka hyrë në fuqi me 11 qershor 2018 dhe është e zbatueshme për tre vite nga lidhja e saj. Në nenin 17 paragrafi 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë parashihet se “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, paditësi është i legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësi ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, gjykata vendosi që t’u detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën në lartësi prej 2,039.73 (679.91 euro x3 = 2,039.73) siç ka vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjukata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës të dhënë në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit ku ka theksuar se palë nënshkruese e Kontratës Kolektive Sektoriale është Ministria e Shëndetësisë

dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, nga rezulton se këtu të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv dhe se e njëjta nuk mund të obligohet që t'i kompensojë pagat jubilarë të paditësit, një pretendim i këtillë nuk qëndron, ngase me neni 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, është specifikuar fusha e zbatimit dhe atë paragrafi 1 citon se: “KKS-së gjen zbatim për rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit në institucionet shëndetësore duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”, tutje paragrafi 2. “Fushë zbatimi i KKS-së ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativ në institucionet shëndetësore”, ashtu që pretendimet e palës së paditur nuk patën influencë për të vendosur ndryshe në kontestin lëndor.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, e llogaritur nga data 10 nëntor 2021.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranua shuma e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 269.00 euro. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë 30.00 euro (sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro, për përfaqësim e të autorizuarit të paditësit në shqyrtimin, në vlerë prej 135.00 euro (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës).

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.714/2021, me 16 nëntor 2021

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada - Glllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:108778
Datë: 16.11.2021
Numri i dokumentit: 02404076